



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:292639

Datë: 22.01.2025

Numri i dokumentit: 06742851

KPPP.nr. 1554/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbaremore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Ceo” Sh.P.K., me nr. unik identifikues 810506785 dhe me seli në Prishtinë, Velani, rr. “Emrush Miftari” nr.12, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 554/2024 të datës 30.09.2024, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Arben Gashi me zyre në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 22.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Ceo” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr. 554/2024 i datës 30.09.2024, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Arben Gashi, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati Farmaceutik, me datë 30.09.2024 ka lëshuar urdhrin P.nr. 554/24 duke lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit - Aktvendim nr. 01/50-50/2024-GJ të datës 31.01.2024 ashtu që është detyruar debitori “Ceo” Sh.P.K., që në emër të gjobës administrative të shqiptuar sipas aktvendimit të lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,100.00 EUR, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor përmes të së cilit ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbareimit me arsyetimin se debitori ka paraqitur padi në konflikt administrativ duke kundërshtuar ligjshmërinë e aktit administrativ, shkak ky mbi bazën e të cilit duhet të pranohet prapësimi dhe të anulohet urdhri për lejimin e përmbareimit.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje ndaj prapësimit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e pranoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Me Ligjit nr. 04/L-39 për Procedurën Përmbartimore, neni 22 par.1 të saj fillimisht ka qenë e përcaktuar që si dokument përmbartues paraqitet *“vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia)”*.

Ndërsa, me Ligjin nr. 08/L-262 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative – faza e dytë, Kapitulli XXIV që i referohet ndryshimeve të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me nenin 77 është përcaktuar se *“ Paragrafi 1.2. i nenit 22 të ligjit bazik fshihet”*.

Nga ndryshimet e lartcekura, rezulton se vendimi i organit administrativ që përbën detyrim monetar, tanimë nuk përbën më titull ekzekutiv dhe nuk paraqet bazë për lejimin e përmbartimit.

Rrjedhimisht, meqenëse propozimi për përmbartim nga kreditori është iniciuar me datë 30.09.2024, ndërsa ndryshimet e LPP-së përmes Ligjit nr. 08/L-262 kanë hyrë në fuqi me datë 23 gusht 2024, pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të Ligjit 08/L-262 në Gazetën Zyrtare, rezulton se në kohën e paraqitjes së propozimit për përmbartim dhe lejimit të përmbartimit, dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi nuk ka paraqitur titull ekzekutiv e rrjedhimisht nuk përbën bazë për lejimin e përmbartimit.

Nga këto të gjetura, e në kuptim të nenit 71, par.1, nën-par. 1.1 të LPP-së me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse *“dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbartueshmërisë”*, u vendos si në dispozivin e këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 71 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1554/24 datë 22.01.2025

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.